



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 6925 Prot.

Tiranë, më 10.07. 2019

Nr. Identifikimi 719

Vendimi 39

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “Autoriteti Portual Durrës”
Nr. NIPT-i: J61811536L
Adresa e selisë: Lagja Nr.1, Rruga tregtare, Porti Detar, Durrës.
Personi përgjegjës: Agron Tare

Për të zhvilluar projektin: “**Thellimi emergjent i basenit dhe kanalit hyrës në portin e Durrësit**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, Pika 8. b) Portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave të trageteve) që mund të marrin anije me mbi 1350 tonë.

Vendndodhja: Porti Detar Durrës

Bashkangjitur Deklaratës, jepen planvendosja dhe të dhënat teknike (Aneks 1, 2)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Nevojat emergjente të thellimit të basenit dhe kanalit hyrës në Port
- Në Deklaratën Mjedisore Nr. 6774Prot, datë: 17.10.2019, Vendimi 50.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.2 Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.

4.3 Kjo Deklarate është e vlefshme pasi subjekti të paiset me leje nga institucionet përkatëse.

4.4 Para fillimit të zbatimit të projektit në terren të hartohet Plani i Menaxhimit Mjedisor.

4.5 Eshte e ndaluar rreptesisht hedhja e mbetjeve apo ujerave te ndotura ne mjedisin ujor detar.

4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë rrugës, me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

4.7 Të bëhet kontroll i vazhdueshëm periodik i aparateve matës e sinjalizues, në rast avarish të bëhet riparimi i menjëhershëm i tyre.

4.8 Të bëhet kontroll i vazhdueshëm periodik i aparateve matës e sinjalizues, në rast avarish të bëhet riparimi i menjëhershëm i tyre.

4.9 Të instalohen pajisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe të mbahet në objekt sasi e caktuar rëre dhe shkume për fikjen e zjarrit në rast aksidenti. Në zbatim të kërkesës së pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 8934, "Per mbrojtjen e mjedisit".

- 4.10 Mbetjet e ngurta urbane që do të krijohen nga ambalazhimi i materialeve që do të depozitohen në magazinë të riciklohen sa të jetë e mundur dhe ato që nuk mund të riciklohen të depozitohen në pikat e caktuara nga Njësia Vendore;
- 4.11 Mbetjet e ngurta urbane që do të krijohen nga ambalazhimi i materialeve që do të depozitohen në magazinë të riciklohen sa të jetë e mundur dhe ato që nuk mund të riciklohen të depozitohen në pikat e caktuara nga Njësia Vendore;
- 4.12 Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit.
- 4.13 Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët (jo herët në mëngjes dhe jo vonë në mbrëmje).
- 4.14 Të merren masat teknike dhe organizative për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe gjenerimit të dherave.
- 4.15 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- 4.16 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.17 Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve inerte dhe të tjera, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.18 Të parashikohen dhe merren masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve në tokë gjatë fazës së instalimit të pajisjeve teknologjike për ndërtimin e veprave, si derdhje lëndësh ndotëse, vajra lubrifikues, graso, karburante etj.
- 4.19 Të përdoren mjete të kolauduara për ndërtimin dhe zbatimin e projekti, me qëllim evitimin e ndotjeve të mundshme si pasojë e dëmtimit apo avarie të mundshme.
- 4.20 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;
- 4.21 Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqjes së kampeve të ndërtimit dhe në vendin e përcaktuar;
- 4.22 Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gomat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave;
- 4.23 Shërbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmëse të punës si pjesë këmbimi për automjete, lubrifikante, goma etj. të bëhen në vende të tilla që të evitojnë dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis;
- 4.24 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren (shpime, cigare etj) dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.25 Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit;
- 4.26 Subjekti të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 4.27 Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit.
- 4.28 Në rast aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM-në, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

- 4.29 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat e Vendimit dhe pasojat e mos-zbatimit të tyre në mjedis dhe në marrëdhëniet e subjektit me organin e dhënies së Vendimit që të evitojnë dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis.
- 4.30 Të pastrohet menjëherë çdo rast ndotje e mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit.
- 4.31 Të bëhet pajisja me tabela informuese dhe drejtuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis brenda zonës së veprave.
- 4.32 Të hartohet Plani i Përballimit të Emergjencave i plotë dhe i detajuar, para vendosjes në funksionim të veprës dhe të raportohet pranë AKM-së për përbajtjen e këtij planit.
- 4.33 Të trajnohen të gjithë punonjësit dhe të njihen me termat e Planit të Përballimit të Emergjencave.
- 4.34 Të njoftohet DRM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- 4.35 Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- 4.36 Në përfundim të punimeve subjekti të dorëzojë pranë AKM-së, një relacion ku të pasqyrohen edhe me foto, të gjitha punimet rehabilituese të territorit përreth.
- 4.37 Pavarësisht kushteve të Vendimit, veprimtaria është e detyruar të zbatojë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI

MINISTRI


BLENDI KLOSI

Aneksi 2. Të dhëna teknike

Emërtimi	Gjatësia (m)	Thellësia (m)	Gjerësia (m)
Kanali Hyrjes	6755	8	120

Emërtimi	Gjatësia (m)	Thellësia (m)	Përdorimi
Kalata 0	78	6,8-7,3	Dispozicion Ushtrisë, Kufirit, etj.
Kalata 1	186	7,1-7,4	Dispozicion Policisë, Doganës, etj.
Kalata 2	293	7,0-8,2	Mallrat e përgjithshme te paletizuara & Ro-Ro
Kalata 3	16	7,3	Mallrat e përgjithshme te paletizuara & Ro-Ro
Kalata 4	173.8	7,3-8,1	Mallrat e përgjithshme te paletizuara & Ro-Ro
Kalata 5	235.9	7,9-10,0	Drithëra
Kalata 6	265	8,6-10,0	Konteiner
Kalata 7&8	400	6,0-9,9	Krociera & Tragete
Kalata 9	180	5,8-10,0	Tragete
Kalata 10	269	5,6-9,4	Rifuxho te ngurta
Kalata 11	153	10,0-11,2	Rifuxho te ngurta

- Sipërfaqja e Basenit - 67 Ha,
- Sipërfaqja e parashikuar e Basenit për thellim - 41.6 Ha,
- Thellësia e basenit ne zonën e rreth-rrotullimit te anijeve - 10.5m CD
- Thellësia pranë kalatës 0, - 6.9 CD (65 m nga balli i kalatës, pjerrësia e skarpatave 1:5),
- Thellësia pranë kalatave 1-4, -7.35 CD (65 m nga balli i kalatës, pjerrësia e skarpatave 1:5),
- Thellësia pranë kalatës 5, - 9.85 CD (65 m nga balli i kalatës, pjerrësia e skarpatave 1:5),
- Thellësia pranë kalatave 10-11, -10.5 CD
- Thellësia e sigurisë paraprake është marre 1.2 m